



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_\_ .05.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim Mbikëqyrje per objektin :Zëvendësim i pjesëshëm i tubacionit magjstral 6" nga Qendra nr.17 Drenove deri ne Dekantimin Usoje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71247000-1 - Mbikëqyrje e Punës se ndërtimit

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,275,831 (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Shërbime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

### **Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen te paraqiten:**

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

### **OSE**

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Bazuar ne *Vendimin e Këshillit te Ministrave Nr.759 datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM Nr.943 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.759 datë 12.11.2014 Operatori Ekonomik duhet të disponoje Liçense profesionale te vlefshme, per mbikqyrje, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise me kategoritë si më poshte:*

NP - 1 Punime gërmimi në tokë  
N.P – 2 Ndërtime civile e industriale;  
NP - 7 b Vepra naftesjellese-gazsjellese-vajsjellese  
NP -11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

N.S - 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;

NS – 18 Punime topogjeodezike

Në rast te bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë licensat në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim ne kontratën e bashkëpunimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të licencuar për kryerjen e shërbimit të mbikqyrjes dhe pikat e licencës të kërkuara janë në përputhje me volumet dhe tipologjinë e punimeve që do të kryhen për të cilat kërkohet shërbimi i mbikqyrjes. Ky kriter është në përputhje të plotë dhe proporcional lidhur me kontratën objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- 1 (një) Drejtues Projekti (Inxhinier Ndërtimi/Hidroteknik)

Operatori Ekonomik për Drejtuesin/it Teknik të sipërpërmendur, te deklarojë se ata nuk jane te angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë te pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt

**Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit te larte/licenca.

- Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit ne te cilat inxhinieri/et e siperpermendur duhet te figurojne.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike

**Argumentimi:** Operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e suksesshëm të kontratës bazuar në neni 77, pika 4, të Ligjit 162/2020, “ Për prokurim publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e stafit kryesor i është referuar Termave të Referencës dhe bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt – preventivin e objektit.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

2.3.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e shërbimit të mbikqyrjes, jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqerisë, minimalisht inxhinieret si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf 1 (një)

**Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë/licenca.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit ne te cilat inxhinieret e siperpermendur duhet te figurojne.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit të inxhinierëve i është referuar tipologjisë dhe volumeve të kontratës së zbatimit për të cilën kërkohet shërbimi i mbikqyrjes.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si “Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave” e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjesit me certifikatën përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma (b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 *Për sigurinë dhe shëndetin në punë*, sipas të cilit: *Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes duhet të ketë një punësim prej minimalisht 6 (gjashtë) persona të paktën muajin e fundit.

Për këtë të paraqitet:

- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për të paktën muajin e fundit.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e fuqisë punëtore në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësinë teknike dhe kanë fuqinë punëtore dhe staf të specializuar për kryerjen e shërbimit të mbikqyrjes dhe ky kriter është në përputhje të plotë dhe proporcional lidhur me kontratën objekt prokurimi

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anetarët e BOE.*
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anetarët e BOE*
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) - ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anetarët e BOE.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të kësaj kërkesë AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit cilësisë, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes dhe sigurisë në punë të punonjësve dhe këto kritere janë vendosur në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

---

**SHENIM:** Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik duhet të jetë në përputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kësaj VKM. Kjo kërkesë bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016.

Të gjitha ofertat që do të jenë me vlerë më të ulët se vlera minimale ose më të lartë se vlera maksimale e përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, **do të refuzohen.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Njesia e prokurimit:**